



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR. 03/L – 149, nenit 4 dhe 15 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil si dhe Rregulloren 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM
për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Udhëheqës i Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte
Referenca:	BNP/ZKA/16-08/17
Koeficienti:	9 (nëntë)
Numri i pozitave:	1 (një)
Përgjegjësitë mbikëqyrëse:	Jo
I përgjigjet:	Auditorit të Përgjithshëm
Vendi:	Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Udhëheqësi i Njesisë për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, menaxhon dhe koordinon aktivitete bashkëpunuese ndërkombëtare të ZKA-së me ISA-të, dhe institucioneve të tjera, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve të ZKA-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të ZKA-së, në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave me Institucionet Supreme të Auditimit, për të maksimizuar dobitë dhe lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm të auditimit publik;
2. Përgjegjës për zhvillimin dhe planifikimin e propozime për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve tjera si dhe vlerëson propozimet e pranuar nga jashtë;
3. Siguron përpunimin, koordinimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në projekte të bashkëpunimit dhe siguron zbatimin e tyre;
4. Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe bashkëpunuese;
5. Koordinon dhe ofron mbështetje për pjesëmarrjen e punonjësve të ZKA-së në grupe ndërkombëtare të punës dhe projekte të përbashkëta të auditimit;
6. Kryen funksionin ndërlidhës në aktivitetet me organizatat profesionale të auditimit dhe Institucionet Supreme të Auditimit;
7. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet e njesisë që kërkojnë shqyrtim nga mbikëqyrësi;
8. Kryen detyra tjera sipas kërkesave nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë fakulteti, në fushën e ekonomisë, drejtësisë apo administratës publike;
- Përvojë pune profesionale së paku prej gjashtë (6) vitesh, prej tyre tri (3) vite përvojë menaxheriale;
- Të posedoj aftësi të mira komunikimi dhe në të shkruar për gjuhët zyrtare dhe gjuhës angleze;
- Aftësi hulumtuese në projekte relevante për veprimtarinë e ZKA-së;
- Aftësi në hartimin, prezantimin dhe koordinimin e projekteve;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale;
- Shkathtësi të mira organizative;
- Shkathtësi të mira në komunikim.

Procedura e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil të Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 10.08.2017 deri më datën 17.08.2017, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Departamentit të Burimeve Njerëzore (DBNJ) të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore, tel: 038/606-004/1025 ose 038/606-004/1011, prej orës 08:00 – 16:00.

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.